



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 23 Prill 2021

Nr: 42

VENDIMI

“PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 23 TË PARTISË ALEANCA  
DEMOKRACIA E RE”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Kryesues
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

**Ankues:** Partia Aleanca Demokracia e Re;

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 23, të partisë Aleanca Demokracia e Re me objekt refuzimin e kërkesës 22.04.2021, të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 38, qarku Tiranë dhe pranimin e listës së vëzhguesve të Partisë Aleanca Demokracia e Re.

**BAZË LIGJORE:** Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “c” 6, 124, 132, 133, 143 pika 1 shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; neni 65, shkronja “ç” i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.si dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



Data: 23 Prill 2021  
Nr. 42, Ora 12:30

Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 23 të Partisë Aleanca Demokracia e Re

### **Rrethanat e çështjes:**

1. Subjekti zgjedhor Aleanca Demokracia e Re ka bërë kërkesë për akreditim vëzhguesish pranë KZAZ-së nr. 38. KZAZ-ja nr. 38 ka rrëzuar kërkesën me vendimin pa numër, datë 22.04.2021 *“pasi është jashtë afateve ligjore të përcaktuara me vendimin nr.8, datë 04.03.2021 nga Komisioni Rregullator i KQZ-së”*.
2. Subjekti zgjedhor Aleanca Demokracia e Re ka paraqitur ankim ndaj vendimit të sipërcituar të KZAZ-së nr. 38 më datë 22.04.2021, brenda afatit ligjor të përcaktuar për ankimimin në KAS të vendimeve të KZAZ-ve.
3. Kërkesa ankimore u regjistrua nga KQZ-ja me numrin 23. KAS-i caktoi me short relator për kërkesën ankimore z. Koli Bele. Në seancën përgatitore të datës 23.04.2021 KAS-i vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 23.04.2021, ora 12:30. Seanca u zhvilluar me praninë e përfaqësuesve të subjektit ankues z. Edmond Stojku, z. Endrit Osman, si dhe të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së.
4. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
  - Kërkesën ankimore nr.23, datë 22.04.2021 të subjektit zgjedhor Aleanca Demokracia e Re;
  - Vendimin pa numër, datë 22.04.2021 të KZAZ-së nr. 38;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

### **KAS-i konstatoi:**

1. Afati për paraqitjen e kërkesave për akreditim është përcaktuar në pikën 5 të nenit 6 të Kodit Zgjedhor. Në këtë pikë theksohet se *“kërkesat e vëzhguesve shqiptarë për akreditim i paraqiten KQZ-së jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve”* dhe se *“KQZ-ja miraton kërkesat jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e tyre”*. Gjithashtu, pika 6 e të njëjtit nen i njuh të drejtën KQZ-së që të delegojë tek KZAZ-të kompetencën për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Ky delegim është vënë në lëvizje nga KQZ-ja dhe, mbështetur në këtë modalitet, udhëzimi nr.02, datë 02.02.2021 *“Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjekteve zgjedhore”* dhe udhëzuesi *“Për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor,*

për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021” (miratuar me vendimin e Rregullatorit nr. 08, datë 04.03.2021) kanë konfirmuar kompetencën e KZAZ-ve dhe afatin e fundëm 15 ditor (data 10 prill) për paraqitjen e kërkesave për akreditim vëzhguesish nga subjektet zgjedhore (pika 3 e nenit 9 të udhëzimit nr.02, datë 02.02.2021 dhe faqja 28 e udhëzuesit).

2. Subjekti zgjedhor ankues nuk ka paraqitur pranë KZAZ-së asnjë justifikim të ligjshëm për tejkalimin e afateve ligjore për depozitimin e kërkesave për akreditim vëzhguesish. Afatet ligjore për akreditimin e vëzhguesve nuk janë afate prekluzive, por kjo nuk do të thotë se afati mund të shkelet nga subjekti apo se subjekti mund të rivendoset në çdo kohë në afat, pa shkak dhe as justifikim ligjor. Marrëdhënia juridike që lidhet me afatin për akreditimin e vëzhguesve bashkon të drejtën e subjektit për të kërkuar akreditim, me detyrimin e administratës zgjedhore për të autorizuar akreditimin. Në rastin konkret e drejta e subjektit për të kërkuar akreditimin nuk bie në dekadencë (për shkak të mungesës së prekluzivitetit), por administrata zgjedhore çlirohet nga detyrimi për të plotësuar kërkesën e subjektit.
3. Afatet e akreditimit janë përcaktuar në ligj si një masë për disiplinimin e marrëdhënieve midis palëve dhe si nevojë për organizimin racional të ngarkesës së punës për administratën zgjedhore. Nga ana tjetër ato nuk formojnë barrë të pa arsyeshme për subjektet zgjedhore dhe nuk synojnë pengimin e subjekteve për të vëzhguar procesin. Qëllimi i ligjit është transparenca dhe përfshirja, jo mbyllja dhe përjashtimi. Për shkak të tejkalimit të afatit ligjor, KZAZ-ja nr. 38 duhet të shqyrtonte kërkesën jo më mbështetur në detyrimin ligjor për plotësimin e saj, por mbështetur në nevojën e procesit për vëzhgim dhe transparencë.
4. Nga hetimi administrativ rezultoi se KZAZ-ja nr. 38 nuk ka qenë proaktive në ushtrimin e kompetencave të saj, nuk ka njoftuar paraprakisht subjektet për të drejtën ligjore për të kërkuar akreditim, sikurse nuk i ka paralajmëruar ata për rrezikun e tejkalimit të afateve dhe pasojat që lidhen me to. Interesi madhor i administratës zgjedhore është mbarëvajtja dhe besueshmëria e procesit. Vëzhgimi dhe transparenca i shërbejnë këtij qëllimi. Në këtë kuptim, KZAZ-ja ka pasur një interes të drejtpërdrejtë që të gjitha subjektet të shfrytëzonin të drejtën e tyre ligjore, të cilit nuk i ka shërbyer deri në fund. Sjellja proaktive është përcaktuar si metodë pune edhe në rrethin e detyrave të KZAZ-së, sikurse i përcakton ato udhëzuesi “Për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”. Pika IV-3 e udhëzuesit i kërkon KZAZ-së që të jetë proaktive, të komunikojë, informojë dhe paralajmërojë subjektet zgjedhore si përsa i përket

depozitimit të listave të kandidatëve apo depozitimit të listave të komisionerëve dhe numëruesve, ashtu dhe për plotësimin e vakancave apo kryerjen e trajnimeve. Akreditimi i vëzhguesve është, për nga rëndësia, i barasvlershëm me dërgimin e komisionerëve apo plotësimin e vakancave. Prandaj KZAZ-ja duhet të kishte kërkuar bashkëpunim dhe të kishte nxitur subjektet zgjedhore që t'u dilnin zot të drejtave dhe mundësive që u jep ligji, përpara se afatet të shteronin.

5. Shumica e KZAZ-ve kanë kryer akreditimin e vëzhguesve të subjekteve ankuese, përtej afatit ligjor, jo si detyrim ndaj subjekteve ankuese, por si interes madhor për mbarëvajtjen e procesit. KAS-i e vlerëson këtë qëndrim si qëndrim dhe veprim të përgjegjshëm dhe të përpiktë. Nga ana tjetër, KAS-i çmon se nevoja për zbatimin uniform të ligjit në të gjithë territorin kërkon që këtë sjellje t'a demonstrojë dhe KZAZ-ja nr. 38 me akreditimin e vëzhguesve të subjekteve ankuese.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shumicë votash, KAS-i,

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kërkesës nr. 23 të subjektit zgjedhor Partia Aleanca Demokracia e Re.
2. Detyrimin e KZAZ-së nr. 38 të akreditojë vëzhguesit e subjektit ankues sipas kërkesës së depozituar prej tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Kryesues</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>



## MENDIM PARALEL

1. Ne, anëtarët pakicës së Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, parashtrajmë mendimin tonë paralel ndaj arsyetimit të vendimit nr. 42, datë 23.04.2021, të KAS-it “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.23 të Partisë Aleanca Demokracia e Re”.

Parashtrimi i arsyetimit të mendimit paralel lidhet me qëndrimin ndryshe në raport me vlerësimin e disa rrethanave dhe arsyetimit të përdorur nga shumica e anëtarëve të KAS-it, dhe që nuk ndikon në vendimin për pranimin e kërkesës ankimore të depozituar nga subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokracia e Re.

2. E drejta për të caktuar vëzhgues është një nga garancitë që ligji ofron në kuadër të zhvillimit të një procesi zgjedhor të rregullt, të drejtë dhe të paanshëm. Neni 6 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, normon të drejtën e caktimit të vëzhguesve dhe subjektet që e përfitojnë këtë të drejtë. Këto subjekte ligji i ndan në:

- 1- Subjektet zgjedhore;
- 2- Organizatat joqeveritare shqiptare;
- 3- Organizata ndërkombëtare të huaja;

3. Për secilin nga këto subjekte, neni 6 parashikon rregullime specifike për caktimin e vëzhguesve. Për vëzhguesit e caktuar nga subjektet zgjedhore, pika 1 e nenit 6 parashikon se të gjitha subjektet zgjedhore kanë të drejtën e caktimit të një vëzhguesi në KZAZ, në KQV dhe në çdo tavolinë në VNV. Këto vëzhgues caktohen pas regjistrimit të subjektit zgjedhor dhe pas paraqitjes së listës shumëmemërore. Pra, nuk vendoset asnjë afat prekluziv për caktimin e vëzhguesve nga subjektet zgjedhore.

3. Për sa i përket vëzhguesve të caktuar nga organizatat shqiptare dhe të huaja, pika 5 e nenit 6 përcakton se afati për caktimin e tyre është respektivisht jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve për vëzhguesit e caktuar nga organizatat shqiptare, dhe jo më vonë se 72 orë para datës së zgjedhjeve për vëzhguesit e caktuar nga organizatat e huaja.

4. Referuar udhëzimit nr. 2, datë 02.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, pasi bën ndarjen e subjekteve që kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues sipas ndarjes së cituar më lart; në nenin 9 përcakton afatet e kërkesave për akreditim, ku ndër të tjera, përpos afatit 15 ditë dhe 72

orë për vëzhguesit shqiptarë dhe ata të huaj, në pikën 3 përcakton një afat prej 15 ditësh para datës së zgjedhjeve për kërkesat e paraqitura nga subjektet zgjedhore.

Ne gjykojmë se në asnjë rast, një afat i caktuar nga një akt nënligjor i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ligjit, nuk mund të dalë tej afateve të vendosura nga vetë ligji. Në rastin tonë Kodi Zgjedhor nuk përcakton asnjë afat prekluziv për kërkesat për caktimin e vëzhguesve nga subjektet zgjedhore.

Pakica vlerëson se kualifikimi (kategorizimi) i ndryshëm që ligjvënësi ka bërë në pikat 1 dhe 2 të nenit 6 të Kodit Zgjedhor, respektivisht për vëzhguesit e subjekteve zgjedhore nga vëzhguesit Shqiptarë (shoqëria civile, media, etj) apo vëzhguesit e huaj, ka një shkak logjik që lidhet me rolin e palëve në këtë proces.

Përfundimisht, ne mendojmë se KZAZ-ja duhet të pranojë listat e vëzhguesve të depozituara nga subjektet zgjedhore, në cilëndo kohë që ato paraqiten.

**Koli BELE - Kryesues**

**Elvin LAKO - Anëtar**